



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:136586
Datë: 03.01.2024
Numri i dokumentit: 05149783

AA.nr.972/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit - propozuesit B... (R...) B... nga fshati Zh..., Komuna e Prizrenit, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Drejtësisë, me baza juridike anulim i njoftimit për shpalljen publike për dhënien e provimit për noterinë me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit - propozuesit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1150/2023, të datës 14.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.12.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit - propozuesit B... (R...) B... nga fshati Zh..., Komuna e Prizrenit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1150/2023, i datës 14.11.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1150/2023, të datës 14.11.2023, është hedhë poshtë si i palejueshëm, propozimi i paditësit - propozuesit B... (R...) B.. nga fshati Zh..., Komuna e Prizrenit, me të cilin ka kërkuar që të anulohet konkursi i shpallur i dt.01.11.2023.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë paditësi - propozuesi B... (R..) B..., pa përcaktim të asnjë baze ligjore: duke kërkuar që aktvendimi i ankimuar të korrigohet duke sjell aktvendim me të cilin shfuqizohet aktvendimi A.nr. 1150/2023 i datës 14.11.2023 dhe lënda të kthehet në rivendosje. Ngase kjo ankesë nuk mendoj se duhet të bëhet në mënyrë profesionale por gjykata e shkallës së dytë duhet të vendos për profesionalitetin e saj dhe ti korrigjoj gabimet e gjyqtarëve të shkallës së parë, kur dihet se ka bazë ligjore për

pezullimin e konkursit për noter të shpallur me datë 01.11.2023. nëse kemi shtet ligjorë dhe të drejt dhe nëse ende kemi gjyqtarë që vendosin si ekspert të çështjes, atëherë e njëjta ankesë duhet të aprovohet në të kundërtën duhet të vepohet shabllon si gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktin Administrativ (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, duke shqyrtuar padinë dhe shkresat e lëndës, ka vërejtur se paditësi – propozuesi paditësi ka paraqitur padi me propozim për caktimin e masës së sigurisë dhe po ashtu i njëjti përmes parashtrësës së dt. 14.11.2023 e ka precizuar ne kuptimin objektiv, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurisë për pezullimin e procesit të shpalljes së dhënies së provimit të noterisë si dhe të anulohet të njëjtin proces të shpalljes së provimit të noterisë të publikuar me datën 01.11.2023. Për të vlerësuar propozimin/kërkesën si dhe padinë e paditësit/propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, gjykata e shkallës së parë iu referua nenit 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar propozimin e paditësit për shtyrje të konkursit ju ka referuar dhe nenit 13 të LKA-së, paragraf.2 në të cilin theksohet se “*Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar*“. Ne rastin konkret paditësi ka mundur të kërkojë shtyrjen e vendimit përfundimtar por jo dhe shtyrjen e konkursit dt.01.11.2023, meqë konkursi nuk është akt i formës për të cilën mund të kërkojë shtyrja e ekzekutimit të tij në kuptim të nenit 13 paragraf, 1 dhe 2 i Ligjit të Konfliktëve Administrative (LKA-së). Prandaj, propozimi për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit është hedh si i palejuar.

Sepse me dispozitën e nenit 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, përcaktohet se: “*Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar*”. Ndërsa me dispozitën e nenit 13 të të njëjtit Ligj, përcaktohet se “*1. Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar*”. Kurse me nenin 15 par.1 të të njëjtit ligj, përcaktohet se: “*1. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: 1.1. kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ; 1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ; 1.3. kundër akteve administrative, që përbëjnë një detyrim të përgjithshëm, të nxjerra nga organet e administratës, përveç kur ato cenojnë të drejtat e ligjshme të palëve*”.

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore të lartcekura, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me të drejtë e ka hedhë poshtë propozimin e paditësit - propozuesit në këtë çështje juridiko-administrative si të palejuar. Ngase nuk ka paraqitur padi me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit kundër aktit administrativ përfundimtar, meqë njoftimi për shpalljen publike për dhënien e provimit për noterinë nuk është akt i formës së prerë për të cilin mund të kërkohet shtyrja e ekzekutimit të tij, në kuptim të nenit 13 paragraf, 1 dhe 2 i Ligjit të Konfliktëve Administrative. Sepse edhe me nenin 17 par.1 të Ligjit Nr.06/L-054 për Gjykatat, përcaktohet se “Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare, dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj”.

Pra, në këtë rast vërehet se kërkesa e paditësit - propozuesit nuk mund të jetë objekt shqyrtimi në procedurën e konfliktit administrativ, për faktin se vendimi i të paditurës i goditur me padi nuk është akt përfundimtar në procedurën administrative. Prandaj, në këtë rast paditësi-propozuesi ka mundur që të kërkojë shtyrjen e ekzekutimit të vendimit përfundimtar të siguruar me ankesë në këtë procedurë, por jo shtyrjen e ekzekutimit të procesit të shpalljes së dhënies së provimit të noterisë si dhe anulimin e të njëjtit proces të shpalljes së provimit të noterisë të publikuar me datën 01.11.2023 nga Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Drejtësisë. Andaj, të gjitha pretendimet ankimore të paditësit – propozuesit, për anulimin e njoftimit për shpalljen publike për dhënien e provimit për noterinë me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, kolegji i kësaj gjykate i konsideron të pa bazuara dhe pa ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje juridiko-administrative. Sepse, aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa e paditësit-propozuesit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, vlerëson të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar, ngase vendimi është marrë duke respektuar dispozitat ligjore dhe procedurale të parapara me Ligjin për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, kolegji vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 209 pika b) të LPK-së dhe neni 63 të LKA-së, për të vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.972/2023, me datë 27.12.2023

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi